

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËS DHE EKONOMISË
Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik Nr. 4, Tiranë

PROGRAMI

I KURSIT TË VEÇANTË
“LLAMARINIST DHE BOJATISJE
AUTOMJETESH”

Kodi: LLBA-20

Miratoi

DREJTOR

.....

Tiranë, 2020

PROGRAMI I KURSIT TË VEÇANTË

“LLAMARINIST DHE BOJATISJE AUTOMJETESH”

(Kodi: LLBA- 20)

I. Profili Profesional i Lllamarinistit dhe bojatisjes së automjeteve.

a) Karakteristikat e Lllamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve.

Lllamarinisti dhe bojaxhiu për automjete është i aftë të kryejë detyra profesionale si i punësuar apo i vetpunësuar në kompani të shërbimeve të automjeteve të transportit, në servise për punimet e riparimit të lllamarinës dhe llyerjes të këtyre automjeteve.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, lllamarinisti dhe bojaxhiu për automjete duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, me metodat e riparimit dhe kontrollit të lllamarinës së jashtme të automjeteve dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të lllamarinistit dhe bojaxhiut për automjetet e transportit, si në riparime të kofanos, shasisë, parafangove, traversave, e tje, me proceset e pastrimit, stukimit, zmerilimit, llyerjes dhe luçidimit të lllamarinës së automjeteve.

Suksesi i lllamarinistit dhe bojaxhiut për automjete është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathtësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

b) Mundësitw e punwsimit dhe karriera profesionale e Lllamarinistit dhe bojaxhiut te automjeteve.

Profesioni i lllamarinistit dhe bojaxhiut për automjetet, është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për riparimin e lllamarinës dhe llyerjes së automjeteve. Ai mund të punësohet në kompani të mëdha që ofrojnë shërbime të ndryshme për automjetet, në servise për riparime dhe llyerjen e lllamarinës dhe pjesëve plastike të automjeteve.

Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë, lllamarinisti mund të përparojë profesionalisht në nivelin me të lartë të lllamarinistit dhe llyerjes të automjetit. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale, trajnimit në qendra të formimit profesional apo nëpërmjet punës, një lllamarinist dhe bojaxhi për automjetet mund të vetpunësohet në servisin e vet, duke arritur nivelet e mjeshtrit.

Për të zhvilluar veprimtari private në sektorin e shërbimeve për riparime të lllamarinës dhe llyerjes së automjeteve të lehta, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Punonjësit në këtë profesion mund të specializohen në fushat e mëposhtme, të tilla si: , xhenerik, motorist, elektroauto, gomist, pompist, baterist etj.

II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për “Lllamarinist dhe bojatisje automjetesh”.

Në përfundin të Kursit për Lllamarinist dhe bojatisje automjetesh, kursantët do të jenë të aftë të:

- realizojnë organizimin e vogël të punës në repartin ose servisin për punime lllmarine dhe llyerje automjetesh;
- zbatojnë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- përzgjedhin dhe përdorin veglat, pajisjet, instrumentat, makineritë dhe materialet e duhura të punës;
- mirëmbajnë veglat, materialet, pajisjet dhe makineritë në mjedisin e punës;

- realizojnë procedurat e çmontimit dhe të montimit të pjesëve të lëvizshme të automjeteve;
- kryejnë punime përgatitore për riparimin e llamarinës dhe bojatisjen e automjeteve.
- kryejnë riparimin e parafangove të automjeteve;
- riparojnë dyert e automjeteve;
- riparojnë kofanon e automjeteve;
- riparojnë pjesët plastike të automjeteve;
- kryejnë riparime sipërfaqësore të pjesëve alumin të automjeteve;
- riparojnë traversat e automjeteve;
- riparojnë shasinë e automjeteve;
- kryejnë pastrime të llamarinës së automjeteve që do të bojatisen;
- kryejnë stukime të llamarinës së automjeteve që do të bojatisen;
- kryejnë zmerilimin e sipërfaqeve të stukuara të automjeteve;
- kryejnë procesin e lyerjes së automjeteve me bojra të llojeve të ndryshme;
- kryejnë procesin e luçidimit të llamarinës së bojatisur të automjeteve;
- bëjnë kontrollin e pjesëve të riparuar të llamarinës dhe të bojatisura të automjeteve;
- kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me shërbimet e riparimit të llamarinës dhe të bojatisjes së automjeteve;
- zbatojnë standardet e profesionit të llamarinistit dhe bojaxhiut për automjetet;
- komunikojnë me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët.

III. Kërkesat e pranimit në Kursin “Llamarinist dhe bojatisje për automjetet”.

Pjesëmarrësit në Kursin për “Llamarinist dhe bojatisje për automjetet”, duhet të jenë mbi 16 vjeç dhe të kenë përfunduar arsimin e detyruar.

IV. Kohëzgjatja e Kursit “Llamarinist dhe bojatisje automjetesh”.

400 orë mësimore, ku
1 orë mësimore = 45 minuta

V. Modulet e Kursit “Llamarinist dhe bojatisje automjetesh”.

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
-----------	---------------------------	-------------	--------------------	----------------------------

1	Hyrje në profesionin e llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve.	LLBA-01-20	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësimë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve. 2. Kursanti përshkruan pjesët përbërëse të llamarinës së automjeteve. 3. Kursanti përshkruan pajisjet, veglat dhe materialet ndihmëse të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve. 4. Kursanti përshkruan metodat e riparimit dhe të kontrollit të pjesëve dëmtuara të automjeteve. 5. Kursanti kryen llogaritje ekonomike të riparimeve të llamarinës dhe bojatisjes së automjeteve. 6. Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes, gjatë punimeve të llamarinës dhe bojatisjes së automjeteve.
2	Riparime llamarine të automjeteve.	LLBA -02-20	170 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësimë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen punime përgatitore për riparimin e llamarinës së automjeteve. 2. Kursanti riparon parafangot e automjeteve. 3. Kursanti riparon dyert e automjeteve. 4. Kursanti riparon kofanon e automjeteve. 5. Kursanti riparon pjesët plastike të automjeteve 6. Kursanti riparon traversat e automjeteve. 7. Kursanti riparon shasinë e automjeteve. 8. Kursanti kryen riparime sipërfaqësore të pjesëve alumin të automjeteve.
3	Punime përgatitore për bojatisjen e automjeteve.	LLBA-03-20	60 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësimë	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti kryen pastrime të llamarinës së automjeteve që do të bojatisen. 2. Kursanti kryen stukime të llamarinës së automjeteve që do të bojatisen. 3. Kursanti kryen zmerilime të llamarinës së automjeteve që do të bojatisen.

4	Bojatisja e automjeteve.	LLBA-04-20	130 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kursanti përshkruan llojet dhe veçoritë e bojrave për automjetet. 2. Kursanti kryen bojatisjen e automjeteve me bojë pastel. 3. Kursanti kryen bojatisjen e automjeteve me bojë perl dhe llak. 4. Kursanti kryen bojatisjen e automjeteve me bojë metalizato dhe llak. 5. Kursanti kryen bojatisjen e automjeteve me bojra uji dhe llak. 6. Kursanti kryen luçidimin e pjesëve të lyera të automjeteve.
---	--------------------------	-------------------	--	---

VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e kursit për të gjitha rezultatet mësimore që përmbajnë të gjitha modulet e kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë certifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

VII. Përshkruarit e Moduleve të Kursit “Llamarinist dhe bojatisje automjetesh”:

1.Moduli “Hyrje në profesionin e llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve”

<i>PËRSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	HYRJE NË PROFESIONIN E LLAMARINISTIT DHE BOJAXHIUT TË AUTOMJETEVE.	LLBA-01-20
Qëllimi i modulit	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve, me pajisjet, veglat dhe materialet ndihmëse, me procedurat e riparimit dhe kontrollit të pjesëve të dëmtuara të automjetit, me llogaritjet ekonomike për shërbimet e kryera, me rregullat e sigurimit teknik të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve.	
Kohëzgjatja e modulit	40 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori, 10% praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë mbaruar arsimin e detyruar.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat	RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve. <i>Kriteret e vlerësimit:</i>	

e vlerësimit.

- Kursanti duhet të jetë i aftë:
- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve;
- të përshkruajë kërkesat profesionale për llamarinistin dhe bojaxhiun e automjeteve;
- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve;
- të përshkruajë ndërtimin, funksionimin dhe pajisjet e një servisi për riparime llamarine dhe bojatisje automjesh;
- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë kryesore që përdor llamarinisti dhe bojaxhiu për automjete;
- të tregojë organizimin e punës në një servis për punimet e llamarinës dhe bojaxhiut në automjete;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me eprorët, kolegët dhe klientët;
- të përshkruajë kuadrin ligjor bazë që vepron në sektorin e shërbimeve të riparimeve të llamarinës dhe lyerjes të automjeteve;
- të shpjegojë zbatimin e kodit të punës dhe kërkesat ligjore për hapjen dhe veprimtarinë e bizneseve në fushën e shërbimeve të llamarinës dhe lyerjes të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 2 Kursanti përshkruan pjesët përbërëse të llamarinës së automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të përshkruajë mjetet e transportit dhe të bëjë klasifikimin e tyre;
- të listojë pjesët përbërëse të automjeteve;
- të përshkruajë kornizën (shasinë), karrocerinë dhe llojet e tyre;
- të përshkruajë veçoritë dhe llojet e traversave të automjeteve;
- të përshkruajë veçoritë dhe llojet e parafangove të automjeteve;
- të përshkruajë veçoritë dhe llojet e kofanove të automjeteve;
- të përshkruajë veçoritë dhe llojet e pjesëve plastike të automjeteve;
- të përshkruajë veçoritë dhe llojet e pjesëve alumini të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 3 Kursanti përshkruan pajisjet, veglat dhe materialet ndihmëse të llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të dallojë materialet, veglat dhe instrumentet që

- përdoren për riparime llamarine dhe lyerje të automjeteve;
- të tregojë përdorimet e veglave dhe instrumenteve që përdoren për riparime llamarine dhe lyerje të automjeteve;
- të tregojë vetitë dhe përdorimet e materialeve që përdoren për riparimin e llamarinës dhe lyerjes të automjeteve;
- të tregojë standardet e materialeve për riparime dhe lyerje automjetesh;
- të përshkruajë rregullat e mirëmbajtjes të pajisjeve, veglave, dhe materialeve për riparime llamarine dhe lyerje automjetesh;
- të përshkruajë rregullat e ruajtjes dhe kujdesit për pajisjet, veglat dhe materialet që përdoren për riparime llamarine dhe lyerje automjetesh.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 4 Kursanti përshkruan metodat e riparimit dhe të kontrollit të pjesëve të dëmtuara të automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të parafangos së automjeteve;
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të dyerve të automjeteve;
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të traversave të automjeteve;
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të shasisë të automjeteve.
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të kofanos të automjeteve;
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të pjesëve plastike të automjeteve;
- të tregojë llojet dhe shkaqet e dëmtimeve të pjesëve tjera të automjeteve;
- të përshkruajë metodat e riparimit dhe të kontrollit për pjesët e dëmtuara të lëvizshme të automjetit;
- të përshkruajë procedurat për zëvendësimin dhe kontrollin e çdo pjesë të dëmtuar të automjeteve;
- të përshkruajë metodat e riparimit dhe të kontrollit të pjesëve të palëvizshme të dëmtuara të automjeteve;
- të përshkruajë veglat dhe materialet që përdoren për riparimin e çdo pjese të dëmtuar të automjetit.

Instrumentet e vlerësimit

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 5 Kursanti kryen llogaritje ekonomike të riparimeve të llamarinës dhe bojatisjes së automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të kryejë llogaritje të materialeve për riparimin e pjesëve përbërëse të automjeteve;
- të kryejë llogaritje të materialeve për riparimin në tërësi të llamarinës së automjeteve;
- të kryejë llogaritje të materialeve për bojatisjen e pjesëve përbërëse të automjeteve;
- të kryejë llogaritje të materialeve për bojatisjen në tërësi të automjeteve;
- të kryejë llogaritje të sipërfaqeve të llamarinës për lyerje
- të llogarisë kostot e punimeve të pjesëve përbërëse të jashtme të automjeteve;
- të llogarisë çmimet e punimeve të pjesëve përbërëse të llamarinës së automjeteve;
- të llogarisë kostot e lyerjes të pjesëve të vecanta të automjeteve dhe kostot e lyerjes në tërësi të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

RM 6 Kursanti përshkruan rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve të llamarinës dhe bojatisjes së automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të shpjegojë rëndësinë e zbatimit të rregullave të ruajtjes së personit në punë gjatë punimeve të llamarinës dhe lyerjes në automjete;
- të dallojë dhe shpjegojë masat e mbrojtjes në mjediset e punës për riparime të llamarinës dhe lyerjes së automjeteve;
- të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të llamarinës dhe lyerjes së mjeteve të transportit duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre;
- të përshkruajë legjislacionin shqiptar të sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
- të shpjegojë rëndësinë dhe përbërjen e kutisë së ndihmës së parë;
- të përdorë drejt mjetet dhe medikamentet e ndihmës së parë;
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e plagosjeve;
- të shpjegojë dhe zbatojë procedurat për dhënien e ndihmës së parë në rastet e humbjes së vetëdijes;
- të zbatojë rregullat e sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- të përshkruajë masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet e llamarinës dhe punimet e lyerjes në mjetet e transportit;
- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga rryma elektrike,

- të shpjegojë masat e mbrojtjes nga zjarri;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me ngarkesa dhe pesha të rënda;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me pajisje fikse dhe të lëvizshme;
- të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe gjatë kryerjes së punimeve në prani të karburanteve, gazeve të ndryshme, bojrave dhe dyliendit;
- të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së mjedisit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Pyetje - përgjigje me shkrim

Udhëzime për zbatimin e modulit.

Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së reparit të shërbimeve të punimeve të llamarinës dhe ljerjes së automjeteve. Rekomandohen dhe vizita në servise të automjeteve që ofrojnë shërbime të riparimit të llamarinës dhe ljerjes së automjeteve.

Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegime të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.

Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e servisit për shërbime të llamarinës dhe ljerje të automjeteve. Atyre duhet ti jepen detyra të ndryshme në lidhje me çështjet që trajtohen në modul. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë. Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së njohurive teorike dhe shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.

Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit.

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
 - Reparte për shërbime llamarine të automjeteve.
 - Automjete, pjesë të llamarinës dhe plastike të automjeteve, makete.
 - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
- Medie didaktike (CD, filma, etj) për konkretizimin e njohurive.
-

2. Moduli “Riparime llamarine të automjeteve”

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe kodi	RIPARIME LLAMARINE TË AUTOMJETEVE.	LLBA -02-20
Qëllimi i modulit	Një modul teoriko-praktik që i aftëson kursantët me metodat e riparimit dhe të kontrollit, të parafangove, dyerve, traversave, shasisë, kofanos dhe të pjesëve plastike dhe alumin të automjeteve.	
Kohëzgjatja e modulit	170 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori, 80% praktikë, 10% Vlerësim	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Kursantët duhet të jenë mbi 16 vjeç. Të kenë mbaruar arsimin e detyruar. Të kenë përfunduar Modulin 1 “Hyrje në profesionin e llamarinistit dhe bojaxhiut të automjeteve”.	
Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit.	<p>RM 1 Kursanti kryen punime përgatitore për riparimin e llamarinës së automjeteve . <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të bëjë analizën e automjetit që do të riparohet;- të bëjë pastrimin në tërësi të automjetit që do të riparohet;- të bëjë zmontimin e nyjes që do të riparohet;- të bëjë konstatimin e difekteve në njëjën e dëmtuar të zmontuar;- të përcaktojë mënyrat e riparimit në thellësi të nyjes së dëmtuar;- të përzgjedhë dhe sjellë në vendin e punës veglat, pajisjet dhe materialet e nevojshme të punës për riparimin e nyjes së dëmtuar;- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit, shëndetit gjatë përgatitjes së vendit të punës për punime përgatitore për riparimin e llamarinës. <p><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></p> <ul style="list-style-type: none">- Pyetje- përgjigje me gojë- Vëzhgim me listë kontrolli	
	<p>RM 2 Kursanti riparon parafangot e dëmtuara të automjetit. <i>Kriteret e vlerësimit:</i> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për riparimin e parafangove të automjetit;- të përcaktojë dëmtimin e bërë në parafangot, në nyjet që do të kryhet riparimi;- të vlerësojë dëmtimet e bëra;- të përgatitë vendin e punës për riparimet e parafangove të automjetit;- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për riparimet e parafangove të automjetit;- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës;- të zbatojë procedurën e çmontimit të pjesshëm të parafangos së automjetit;	

- të bëjë zmerilimin e bojës ekzistuese të parafangos së automjetit;
- të zbatojë procedurën e pastrimit në mënyrë të saktë të parafangos së automjetit;
- të bëjë riparimin e parafangos më anë të spoterit;
- të bëjë riparimin e parafangos me çekiç prej druri;
- të zbatojë procedurën e riparimit të parafangos me çekiç të llojeve të ndryshme prej çeliku, sipas nevojës;
- të bëjë punime të parafangos me anë të levave të ndryshme;
- të drejtojë llamarinën e parafangos së automjetit;
- të realizojë kontrollin e riparimit të bërë të parafangos së automjetit;
- të zbatojë procedurën e montimit dhe akopjimin e parafangos në automjet;
- të realizojë kontrollin në simetri të pjesëve të montuara
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të parafangos së automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 3 Kursanti riparon dyert e automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për riparimin e dyerve të automjetit;
- të përcaktojë dëmtimin e bërë në dyert, në nyjen në të cilën do të kryhet riparimi;
- të vlerësojë dëmtimin e bërë në dyert e automjetit, i lehtë, ose riparim me i thelluar;
- të përgatitë vendin e punës për riparimet e dyerve të automjetit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për riparimet e dyerve të automjetit;
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës;
- të zbatojë procedurën e çmontimit të dyerve të automjetit;
- të bëjë zmerilimin e bojës ekzistuese të dyerve të automjetit;
- të zbatojë procedurën e pastrimit në mënyrë të saktë të dyerve të automjetit;
- të bëjë riparimin e dyerve të automjetit më anë të spoterit;
- të realizojë riparimin e dyerve me çekiç prej druri;
- të zbatojë procedurën e riparimit të dyerve me çekiç

- të llojeve të ndryshme prej çeliku, sipas nevojës;
- të bëjë punime të dyerve të automjetit me anë të levave të ndryshme;
- të drejtojë llamarinën e dyerve të automjetit;
- të zbatojë procedurën e kontrollit të riparimit të bërë të dyerve të automjetit;
- të zbatojë procedurën e montimit dhe akopjimin e dyerve në automjet;
- të realizojë kontrollin në simetri të pjesëve të montuara në automjet;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të dyerve të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 4 Kursanti riparon kofanon e automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për riparimin e kofanos së automjetit;
- të përcaktojë dëmtimin e bërë në kofano, në nyjen që do të kryhet riparimi;
- të vlerësojë dëmtimin e bërë në kofanon e automjetit;
- të përgatisë vendin e punës për riparimet e kofanos së automjetit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për riparimet e kofanos së automjetit;
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës;
- të zbatojë procedurën e çmontimit të kofanos së automjetit;
- të bëjë zmerilimin e bojës ekzistuese të kofanos të automjetit;
- të zbatojë procedurën e pastrimit në mënyrë të saktë të kofanos së automjetit;
- të bëjë riparimin e kofanos së automjetit me anë të spoterit;
- të realizojë riparimin e kofanos me çekiç prej druri;
- të zbatojë procedurën e riparimit të kofanos me çekiç të llojeve të ndryshme prej çeliku, sipas nevojës;
- të bëjë punime të kofanos së automjetit me anë të levave të ndryshme;
- të drejtojë llamarinën e kofanos së automjetit;
- të zbatojë procedurën e kontrollit të riparimit të bërë të kofanos së automjetit;
- të zbatojë procedurën e montimit dhe akopjimin e

- kofanos në automjet;
- të realizojë kontrollin në simetri të pjesëve të montuara;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për shërbimet e kryera.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të kofanos së automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 5 Kursanti riparon pjesët plastike të automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për riparimin e pjesëve plastike të automjetit;
- të përcaktojë dëmtimin e bërë në pjesët plastike, në nyjen që do të kryhet riparimi;
- të vlerësojë dëmtimin e bërë në pjesët plastike të automjetit;
- të përgatitë vendin e punës për riparimet e pjesëve plastike të automjetit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për riparimet e pjesëve plastike të automjetit;
- të vendosë në mënyrë të sigurtë automjetin në postin e punës;
- të zbatojë procedurën e çmontimit të pjesëve plastike të automjetit;
- të bëjë zmerilimin e bojës ekzistuese të pjesëve plastike të automjetit;
- të zbatojë procedurën e pastrimit në mënyrë të saktë të pjesëve plastike të automjetit;
- të bëjë riparimin e pjesëve plastike të automjetit më anë të ngrohjes zonale me ajër të nxehtë;
- të realizojë riparimin e pjesëve plastike të automjetit me saldime të ndryshme plastike;
- të zbatojë procedurën e riparimit të pjesëve plastike me ajërngrohës;
- të zbatojë procedurën e kontrollit të riparimit të bërë të pjesëve plastike të automjetit;
- të zbatojë procedurën e montimit dhe akopjimin e pjesëve plastike në automjet;
- të realizojë kontrollin në simetri të pjesëve të montuara
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për materialet;
- të realizojë llogaritjen e shpenzimeve për punën e kryer;
- të plotësojë dokumentacionin teknik dhe financiar për

shërbimet e kryera;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë riparimit të pjesëve plastike të automjeteve.

Instrumentet e vlerësimit:

- Pyetje - përgjigje me gojë
- Vëzhgim me listë kontrolli

RM 6 Kursanti riparon traversat e automjeteve.

Kriteret e vlerësimit:

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën dhe mjetet mbrojtëse për riparimin e traversave të automjetit;
- të përgatitë vendin e punës për riparimet e traversave të automjetit;
- të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe instrumentet për riparimet e traversave të automjetit;
- të vlerësojë dëmtimet e traversave të automjetit;
- të bëjë zmontimin e pjesëve të zmontueshme të automjetit;
- të zbatojë procedurën e vendosjes së makinës në kalibër;
- të bëjë fiksimin dhe nivelimin e makinës në kalibër dhe të bëjë kontrollin me rreze lazer;
- të realizojë riparimin e traversave me anë të kalibrit;
- të realizojë riparimin e traversave me anë të krikut hidraulik;
- të zbatojë procedurën e kontrollit të dimensioneve;
